


BASHKIA SARANDË

RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

*Bazuar në Ligjin 10 440 datë 07.07.2014, shtojca II, pika 10 "Prodhime
Infrastrukturore", kategoria "g" Instalime të kanaleve ujësjellës/akuedotëve në
distanca të largët*



"Ndërtimi i Ujësjellësit Ksamil (Lagja 3) dhe Ujësjellësit Manastir"

SPECIALISTE E MJEDISIT

SULBENA BALILAJ

**ING. SULBENA BALILAJ
V.K.M. E AUDITIM
MJEDISOR- EKSPERTE**

Të dhëna të përgjithshme të projektit

Emri i projektit: Ndërtimi i ujësjellësit Ksamil dhe Manastir



Figura: Pikat koordinative të projektit

Pikat koordinative për Ujësjellësin Ksamil:

1. *Pika koordinative Ujësjellësi Ksamil- Depoja Ujit*

Coordinate System	Easting	Northing
ETRS89	20° 0' 27.2781"	39° 47' 29.6600"
UTM Zone 34N	415029.32	4405095.18
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4415126.04	4406987.80
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	500649.01	4406386.77

2. *Pika kordinative Ujësjellesi Ksamil- Lagja 3 Ksamil*

Coordinate System	Easting	Northing
ETRS89	20° 0' 1.1684"	39° 45' 45.9519"
UTM Zone 34N	414372.64	4401904.74
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4414469.09	4403796.06

KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator 500027.81 4403188.21

Pikat koordinative për Ujësjiellësin Manastir:

3. Pikat koordinative Ujësjiellësi Manastir: Depoja Ujit

Coordinate System	Easting	Northing
ETRS89	20° 0' 35.2346"	39° 48' 2.2662"
UTM Zone 34N	415229.67	4406098.35
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4415326.47	4407991.37
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	500838.21	4407392.43

4. Pika koordinative Ujësjiellësi Manastir: Fshati Manastir

Coordinate System	Easting	Northing
ETRS89	20° 0' 36.6734"	39° 48' 10.9753"
UTM Zone 34N	415266.86	4406366.48
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4415363.67	4408259.61
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	500872.41	4407661.04

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	4
2. METODIKA E STUDIMIT TË VNM	5
STUDIMI STRUKTUROHET NË KATËR FAZA :	
• NGRITJA E OBJEKTIVAVE ORIENTUESE TË VNM-SË.....	5
• MBLEDHJA E MATERIALIT BAZË EKZISTUES DHE ATIJ TË FORMULUAR ENKAS PËR KËTË PROJEKT DHE SELEKSIONIMI I TYRE PËR PËRDORIM.....	5
• VERIFIKIMI NË TËRENI I TË DHËNAVE EKZISTUESE DHE MBLEDHJA E TË DHËNAVE BIOFIZIKE DHE HUMANE.....	5
• HARTIMI I PROJEKTIT BAZUAR TEK PARASHTESA SI DHE SUBJEKTET VENDIMMARRËSE DHE KONTROLLUES TË OBJEKTEVE MJEDISORE NË NIVEL VENDOR.....	5
3. LEGJISLACIONI	6
4. PËRMBAJTJA E VNM- SË	7
4.1. DOKUMENTACIONI I RAPORTIT MJEDISOR.....	7
4.2. RAPORTI I VLERËSIMIT MJEDISOR.....	7
4.3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË PËRGJITHSHME NË MJEDIS.....	7
5. TREGUESIT E PROJEKTIT TË FURNIZIMIT ME UJË.....	12
6. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË FURNIZIMIT ME UJË	12
6.1. ZONA E PROJEKTIT.....	12
7. QËLLIMI I PROJEKTIT.....	14
8. TË DHËNA TEKNIKE.....	14
8.1. PËR ZONËN E LAGJES NR. 3 KSAMIL.....	14
8.2. PËR FSHATIN MANASTIR.....	15
9. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË FURNIZIMIT ME UJË.....	16
10. TË PËRGJITHSHME PËR VNM.....	17
11. TË DHËNAT BAZË PËR PROJEKTIN.....	17
11.1. PEJSAZHI NATYROR.....	18
11.2. TË DHËNA GJEOGRAFIKE.....	19
11.2.1. QYTEZA E KSAMILIT.....	20
11.2.2. FSHATI MANASTIR	20

**FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM I LAGJES NR.3 (MARINA), KSAMIL DHE I FSHATIT MANASTIR ,
KOMUNA KSAMIL**

11.2.3. GADISHULLI I KSAMILIT.....	21
11.2.4. GJIRI I PALLAVRAQIT	21
11.2.5. LIQENI I BUTRINTIT.....	21
11.2.6. LAGUNA E BUTRINTIT.....	22
11.3. TË DHËNA SIZMIOLOGJIKE.....	22
11.4. TË DHËNA KLIMATERIKE DHE HIDROLOGJIKE.....	22
11.4.1. TEMPERATURA.....	22
11.4.2. RRESHJET.....	23
11.4.3. ERËRAT.....	23
11.5. TË DHËNA HIDROGJEOLGJIKE DHE GJEOLGJIKE.....	23
11.6. TË DHËNA MBI SHFRYTEZIMIN E TOKËS , TË DHËNA PEDOLOGJIKE	24
11.7. TË DHËNA MBI BOTËN BIMORE DHE SHTAZORE.....	24
11.7.1. FLORA.....	24
11.7.2. FAUNA.....	24
11.8. TË DHËNAT ARKEOLOGJIKE.....	25
12. ANALIZA E NDIKIMIT NË MJEDIS.....	25
13. MATRICA E ÇESHTJEVE/NDIKIMEVE MJEDISORE.....	26
13.1. NDIKIMET E LIDHURA ME FAZËN E NDËRTIMIT/EKZEKUTIMIT TË PUNIMEVE CIVILE.....	27
13.2. NDIKIMET MJEDISORE NË FAZËN E FUNKSIONIMIT DHE MIRËMBAJTJES.....	30
13.2.1. NDIKIMET NGA FUNKSIONIMI I REZERVUARËVE DHE VEPRËS SË MARRJES SË UJIT.....	30
13.2.2. NDIKIMI NGA TUBACIONET E LINJËS SË DËRGIMIT DHE RRJETI I SHPËRNDARJES.....	30
13.2.3. NDIKIMET NGA PROCESI I DEZINFEKTIMIT TË UJIT- SISTEMI I UJËSJELLËSIT.....	31
14. PËRMBLEDHJE E NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME MJEDISORE.....	31
15. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	32
15.1. KONKLUZIONE.....	32
15.2. REKOMANDIME.....	32

1. HYRJE

Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) është një studim i cili ka për qëllim përcaktimin e impakteve mjedisore që do të ketë projekti në mjedisin tokë, ujë , ajër dhe synon parashikimin e të gjitha efekteve të pritshme në mjedis.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara

Raporti i VNM-së siguron që ndikimet mjedisore të rëndësishme janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë në mënyrë të kënaqëshme në planifikim, projektim dhe zbatim të projektit.

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

- Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
- Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.

- Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

2. METODIKA E STUDIMIT TË VNM-së

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u orientua nga rëndësia e aktivitetit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre në identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes së projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive sidomos në kompensime indirekte mbi komunitetin.

Studimi strukturohet në katër faza:

1. Ngritja e objektivave orientuese të VNM-së
2. Mbledhja e materialit bazë ekzistues dhe atij të formuluar enkas për këtë projekt dhe seleksionimi i tyre për përdorim
3. Verifikimi në tëren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave biofizike dhe humane.
4. Hartimi i projektit bazuar tek parashtesa si dhe subjektet vendimmarrëse dhe kontrollues të objekteve mjedisore në nivel vendor.

3. LEGJISLACIONI

- Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji nr.10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit”
- Ligji nr.10 440, datë 07.7.2011”Për vlerësimin e ndikimit në mjedis “
- Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Ligji nr. 9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”
- VKM nr. 435 datë 12.09.2002 “Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- VKM nr.177 datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”
- VKM nr. 248 dat; 24.04.2003 “Për miratimin e normave të përkohëshme të shkarkimeve në ajër dhe zbatimin e tyre”
- VKM nr. 804 datë 04.12.2003 “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihet në mbrojtje
- Udhëzim nr. 8 datë 27.11.2007 “Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

4. PËRMBAJTJA E VNM- së

4.1. DOKUMENTACIONI I RAPORTIT MJEDISOR

Ky raport bazohet në të dhënat e marra për projektin gjatë:

- Studimit të mjedisit bazë
- Punës kërkuese për mbledhjen e të dhënave vecanërisht për hartimin e këtij raporti

4.2. RAPORTI I VLERËSIMIT MJEDISOR

Përgatitja e Raportit Paraprak të Vlerësimit Mjedisor është bërë duke u bazuar në kërkesën e kryer nga Komuna Ksamil sipas projektit të hartuar për “Furnizimin me ujë të pijshëm të lagjes nr. 3 (Marina), Ksamil dhe fshatit Manastir, Komuna Ksamil”

4.3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË PËRGJITHSHME NË MJEDIS

Ndikimet mjedisore për ndërtimin e projekti te furnizimit me ujë janë të lidhura me fazat përkatëse afat- shkurtra dhe afat- gjata të investimit si:

- a) zbatimi i punimeve / faza e ndërtimit dhe;
- b) faza e funksionimit

Të cilat mund të përfshijnë:

- sigurine e shëndetit të punëtorëve dhe publikut gjate ndërtimit;
- zhurmat;
- ndikimet vizuale, kufizimet në akses;
- pluhuri i cili ndikon në cilësinë e ajrit,
- germimi i dherave dhe asgjësimi i pjeseve te tepërta si dhera/ tokë dhe materiale të tjera,

- rreziqet në zonat ekologjikisht të ndjeshme, flora dhe fauna, etj.

Gjithashtu, ndikime të veçanta që do të konsiderohen gjatë fazës së ndërtimit janë ato të lidhura me ndërprerje apo ndryshime në regjimet e shërbimeve ekzistuese të furnizimit me ujë dhe efektet e mundshme në cilësinë e ujit.

Kohëzgjatja e projektit pritet të jetë jo më shumë se 12 muaj, dhe punimet mund të mos zhvillohen në të njëjtën kohë në të gjitha zonat, përfituesit mund të ndjejnë vetëm disa nga efektet dhe për një kohë të shkurtër

Ndikimet gjatë fazës së funksionimit të veprave të furnizimit me ujë përfshijnë

- menaxhimin e qëndrueshem të burimeve për të shmangur shfrytëzimin-dhe ndikimet negative në mjedisin përreth.
- mund të ketë disa ndikime vizuale,
- zhurmat nga pompat,
- aksidentet lidhur me klorinimin
- ndikimet nga sasia në rritje e ujërave të zeza,
- rrjedhjet e pakontrolluara për fazën e operimit dhe mirëmbajtjes.

Në vijim paraqitet një listë kontrolli për Masat Zbutëse të sistemeve të furnizimit me Ujë

**FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM I LAGJES NR.3 (MARINA), KSAMIL DHE I FSHATIT MANASTIR ,
KOMUNA KSAMIL**

Komponentët Mjedisorë	Efektet e Mundshme	Masat Zbutëse
<i>Mjedisi Fizik</i>		
Dherat	<ul style="list-style-type: none"> • Dëmtime të strukturës së dheut si pasojë e hedhjes së materialeve, trafikut të transportit, etj. • Humbja e dheut sipërfaqësor gjatë gjurmimeve • Efektet e gjurmimeve për / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera • Erozioni si pasojë e rrjedhjeve sipërfaqësore të pakontrolluara dhe shkarkimit të mbeturinave ujore 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore, shmangia e punimeve në zonat e ndjeshme gjatë kushteve me negativitet të lartë, sigurimi i rrugëve për transport, sipas nevojës, riparimi i zonave të dëmtuara • Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja mbas mbarimit të ndërtimeve • Projektimi i drenazheve dhe mjeteve të tjera të hedhjes së mbeturinave për të siguruar stabilitetin e dheut sipërfaqësor
Toka	<ul style="list-style-type: none"> • Dëmtime të tokës gjatë ndërtimit. Rrëshqitje mbi karpata, faqe kodrash, etj. • Efektet e gjurmimeve / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore • Kryerja e punimeve në mënyrë të tillë që të minimizohet sipërfaqja e ndikuar e tokës • Projektimi i sipërfaqeve të pjerrta dhe strukturave mbajtëse për të minimizuar rrezikun, sigurimi i drenazheve, stabilizimit të dheut/mbulimit të bimësisë • Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja/ripërdorimi mbas mbarimit të ndërtimeve • Transportimi/hedhja e materialeve nga/në vende të aprovuara
Cilësia e Ajrit	<ul style="list-style-type: none"> • Pluhuri dhe tymrat gjatë ndërtimit • Efektet nga trajtimi i ujit 	<ul style="list-style-type: none"> • Të kontrollohet pluhuri me ujë, të kontrollohen metodat e ndërtimit dhe impianti, afatet e punimeve, shpejtësia e automjeteve • Të minimizohen punimet e mëdha brenda komuniteteve • Projektim i përshtatshëm, trajnim në masat e sigurisë të operimit dhe mirëmbajtjes

**FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM I LAGJES NR.3 (MARINA), KSAMIL DHE I FSHATIT MANASTIR ,
KOMUNA KSAMIL**

Komponentët Mjedisorë	Efektet e Mundshme	Masat Zbutëse
Mjedisi Akustik	<ul style="list-style-type: none"> Zhurma nga punimet ndërtimore, stacioni i pompave (kur është afër shtëpive) 	<ul style="list-style-type: none"> Të përcaktohen afatë të punimeve për të minimizuar shqetësimet Të përdoren metoda dhe paisje të përshtatshme ndërtimi Të kufizohet kalimi i trafikut në zonat rezidenciale Projektim apo zgjedhje e kujdeshme e vendndodhjes së impjentit, barriera për zhurmën, p.sh. skarpate me mbeturina dheu
<i>Mjedisi biologjik</i>		
Habitatet Natyrore	<ul style="list-style-type: none"> Shqetësimi i habitateve natyrore nga ndërtimi p.sh. pluhuri, zhurma, punimet jo-sezonale, vendndodhje jo e mirë e kantierit, hedhje e mbeturinave të patrajtuara, etj. Ndryshimet në rregjimin e burimeve ujore 	<ul style="list-style-type: none"> Vendndodhje e kujdeshme e kantierit, kryerje me kujdes e shtrirjes, projektimit të tubacioneve dhe strukturave dhe përcaktimi i kohës së punimeve (sezonale) Përzgjedhja me kujdes e pikave të hedhjes së mbeturinave dhe metodave Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër kantierit Respektimi i kërkesave minimum për punimet sezonale
Fauna dhe Flora	<ul style="list-style-type: none"> Humbja ose degradimi mbas ndërtimeve, sidomos për arsye të punimeve jashtë sezonit, ndryshimet në rregjimet mjedisore, etj. (shih edhe më sipër) 	<ul style="list-style-type: none"> Vendndodhje e kujdeshme e kantierit, kryerje me kujdes e shtrirjes, projektimit të tubacioneve për të minimizuar efektet, sidomos për speciet e ndjeshme/të rralla Përzgjedhja e metodave të përshtatshme ndërtimore Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër kantierit

**FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM I LAGJES NR.3 (MARINA), KSAMIL DHE I FSHATIT MANASTIR ,
KOMUNA KSAMIL**

Komponentët Mjedisorë	Efektet e Mundshme	Masat Zbutëse
<i>Mjedisi Social</i>		
Estetika dhe Terreni	<ul style="list-style-type: none"> • Efekte lokale vizuale mbas përfundimit të punimeve dhe disa ndryshime në terrenin e përgjithshëm natyror dhe të krijuar, humbje pemësh, bimësie, etj. • Zhurma, pluhur, mbeturina, etj. gjatë dhe pas fazës ndërtimore 	<ul style="list-style-type: none"> • Vendndodhje e kujdesshme e kantierit dhe kryerje me kujdes e projektimit të punimeve, kontroll i objekteve të papërshtatshme • Zëvendësim i pemëve të dëmtuara, strukturave të kufijve, etj. dhe ri-gjelbërim i zonave të punimeve. • Kryerje me kujdes e mbylljes së pikave të punimeve dhe hedhjes së mbeturinave
Shëndeti i Njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> • Rreziqe për shëndetin dhe sigurinë gjatë dhe mbas fazës ndërtimore • Efekte mbi shëndetin dhe sëmundje nga mbeturinat e materialeve të rrezikshme të ndërtimit, ujrave e ndotur, trajtim i papërshtatshëm i ujit 	<ul style="list-style-type: none"> • Të zgjidhen kontraktorë me eksperiencë, të përshihen masa sigurie dhe kërkesat mjedisore në dokumentat e kontratës. Të sigurohet informacion mbi masat zbutëse. Krijimi i kapaciteteve të theksojë nevojën për punime më siguri, mbikqyrje të mirë, planifikim dhe parashikim të kujdesshëm të punimeve, përfshirja e komunitetit, rrethimi i zonave të rrezikshme • Projektim i sakte dhe trainim i përshtatshëm për masat e sigurisë të operimit dhe mirëmbajtjes, procedurat e sigurisë, testim uji, etj. • Hedhje e kujdesshme e mbeturinave

5. TREGUESIT E PROJEKTIT TË FURNIZIMIT ME UJË

Indikatorët kryesorë të projektit janë :

- Sigurimi i rritjes së cilësisë së ujit të pijshëm në aspektin e parametrave kimike dhe fiziko-bakteriologjike gjatë gjithë kohës si dhe masave profilaktike për të siguruar këta parametra;
- Sigurimi i rritjes së sasisë së ujit të pijshëm përsa i përket orëve të furnizimit me ujë deri në 20-24 orë / ditë në të gjitha zonat.
- Reduktimi i humbjeve fizike të ujit në sistemin e shpërndarjes deri në 20% dhe më pak.
- Instalimi me matësa uji deri në 100% si për biznesin privat dhe konsumatorët.
- Sigurimi por edhe ruajtja e konsumit të ujit deri në 132 litra për frymë në ditë për banorë, për turista 152 litra në ditë dhe për pushuesit ditorë 32 litra në ditë.
- Mbulimi me linja të furnizimit me ujë deri në 100 % për të gjithë banorët dhe konsumatorët në zonën administrative .
- Krijimi i kushteve teknike për menaxhimin e qëndrueshëm të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe sistemeve të auto-komandimit në nyjet kryesore të furnizimit me ujë (ku është e nevojshme)

6. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË FURNIZIMIT ME UJË

6.1. Zona e projektit të Furnizimit me Ujë

Territori i propozuar për studim ndodhet në zonat periferike të Ksamilit dhe përkatësisht zona në pjesën jugore , lagja nr. 3 , (Marina) si dhe fshati Manastir , të cilat janë pjesë të Komunës Ksamil.

FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM I LAGJES NR.3 (MARINA), KSAMIL DHE I FSHATIT MANASTIR ,
KOMUNA KSAMIL



Lagja nr. 3 Ksamil



Manastiri

7. QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i këtij projekti është furnizimi me ujë të pijshëm i pjesës periferike të Ksamilit, ku si rezultat i ndërtimeve të shumta jashtë kufirit të planit rregullues, kjo zonë nuk furnizohet me ujë. Këto fenomene u panë gjatë hartimit të projektit të rrjetit të brendshëm të Ksamilit , kështu që u morën masa që në dimensionet e rrjetit të shpërndarjes të lihej një rezervë për zgjerim të rrjetit më vonë.

I njëjti fenomen ka ndodhur edhe në zonën e Manastirit , ku ndërtimet kanë qenë të pakontrolluara dhe zona nuk furnizohet me ujë.

8. TË DHËNA TEKNIKE

8.1. Për zonën e lagjes nr. 3 Ksamil:

- Sot Komuna Ksamil ka një popullsi prej 7716 banorë dhe në prespektivë do të ketë një popullsi prej 15.000 banorë.
- Prurja prej 75 lit/sek i përgjigjet nevojave për ujë të një popullsie prej 15.000 banorë dhe 15.000 pushues
- Në llogaritjet hidraulike është lënë edhe një sasi uji plus për nevojat jashtë kufirit të fshatit . Fillimisht kjo sasi ka qenë 8 litra/sek, pra aftësia përcjellëse e rrjetit ishte parashikuar për 83lit/sek , kur për nevojat e fshatit në prespektivë janë llogaritur 75 lit/sek
- Në zonën ku do të zhvillohet projekti llogariten 2100 banorë e pushues , ndërsa në prespektivë llogariten 2900 banorë dhe pushues. Rritja prej 40% është gjykuar për shkak të faktit që vilat e ndërtuara në këtë zone janë pjesërisht banesë e dytë dhe kufiri ndarës popullsi me turist nuk është shumë e qartë
- Normativa 132 litra / frymë/ ditë për familjarë, 152 litra/frymë/ ditë për pushuesit dhe 32 litra/frymë/ ditë për pushuesit ditorë.
- Depua e ujit që furnizon komunën Ksamil ndodhet në vendin e quajtur Qafa e Hartës me një kapacitet prej 3000 m³ (2 x 1500 m³)



- Dimensionimi i rrjetit ka dy elemente : rrjetin kryesorë dhe rrjetin sekondarë.
- Gjatësia e rrjetit kryesorë është 1,3 km
- Gjatësia e rrjetit sekondarë është 4,1 km
- Numuri i lidhjeve është 365 copë dhe për çdo lidhje do vendoset 10 m tubacion PEHD Φ – 250 mm, 10 atm
- Terreni i pjesës shtesë të rrjetit të shpërndarjes është në disfavor me pozicionin e depos, pasi terreni vjen në ngritje, kështu që do të vendoset një pompë pneumatike booster për të rregulluar presionet në katër sekondarët që dalin nga nyja që ka presion të ulët.

8.2. Për fshatin Manastir

- Sot fshati Manastir ka 113 vila dhe popullsia është llogaritur mesatarisht me katër persona në vilë, pra afërsisht 450 banorë
- Turistët janë llogaritur po aq sa edhe banorët, pra 450 persona
- Norma e konsumit është marrë 132 litra/banorë/ditë dhe 152 litra/turistë/ditë

- Prurja llogaritëse e ujësjellësit është 50 litra/sek duke përfshirë edhe prespektivën
- Linja e jashtëme lidhet me ujësjellësin e Ksamilit dhe është 2,52 km
- Pizometri në pikën e lidhjes është kontrolluar për sot dhe për prespektivën dhe është menduar që në kuotën 70 duhet një ngritje e dytë
- Ujësjellësi i jashtëm është llogaritur më ekonomiku me $\Phi - 80$ ose PEHD me diametër të jashtëm $\Phi- 90$
- Rrjeti i brendshëm është menduar me një depo në kuotën 115 m me kapacitet 100 m³, pra me një brez presioni kryesor dhe një degëzim për ndërtimet mbi kuotën 95 m, që do të ndihmohet nga një pompë pneumatike booster.
- Rrjeti ka tre nyje kryesore në të cilin lidhen të gjithë sekondarët.

9. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TEKNIK TË PROPOZUAR

Në vijim jepen detaje të projektit teknik

- Projektimi i magjistralit kryesor për furnizimin me ujë nga depua kryesore në Qafën e Hartës deri në depon që do ndërtohet në fshatin Manastir (kuota + 115 m)

Gjatësia e tubacionit	2520 ml
Sasia e ujit	50 l/sek

- Projektimi i rrjetit të brendshëm
- Projektimi i stacionit të pompimit dhe depos së re me kapacitet 100 m³ (kuota 115 m mbi nivelin e detit) në fshatin Manastir
- Projektimi i rrjetit kryesor që do furnizojë me ujë zonën e lagjes nr.3 Ksamil

Gjatësia e tubacionit	1300 ml
-----------------------	---------

Sasia e ujit 75 l/sek

- Projektimi i rrjetit sekondar për lagjen nr. 3 Ksamil
- Gjatësia e tubacionit 4100 ml
- Numuri i lidhjeve 356 copë

10. TË PËRGJITHSHME PËR VNM

Ky Raport i Përmbledhur i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) ka identifikuar dhe vlerësuar rëndësinë e ndikimit të fuqishëm ambientalist në projektin e propozuar të Furnizimit me Ujë duke përfshirë masat parandaluese dhe lehtësuese për të bërë të mundur që ndikimi i mbetjeve në ambient të jetë i pranueshëm dhe brenda standarteve të aplikuara

Raporti i përmbledhur i VNM bazohet pjesërisht në informacionet e grumbulluara mbi kushtet bazë të mjedisit.

Pavarësisht nga kjo, duhet të bëhet e ditur që projekti do të ketë një ndikim pozitiv për popullsinë e Komunës Ksamil në përmirësimin e furnizimit me ujë, shëndetin publik, si dhe ekonominë e zonës. Me një shërbim të përmirësuar, do të sigurohen kushte më të mira shëndetësore dhe standart jetese për banorët dhe vizitorët e zonës duke konsideruar faktin që Ksamili bën pjesë në një zonë bregdetare turistike.

11. TË DHËNAT BAZË PËR PROJEKTIN

Siç u tha më lart, VNM përfshin një studim të gjerë të të dhënave bazë të kushteve fizike, biologjike dhe kushtet sociale në vendndodhjen e projektit. Teksti i mëposhtëm përmbledh të dhëna të përgjithshme në lidhje me zonën e projektit

11.1. PEJSAZHI NATYROR

Komuna Ksamil përben një nga pasuritë si natyrore edhe arkeologjike më të pasura në vendin tonë. Ajo përben një nga perlat e natyrës shqiptare, me plazhe të pastër e të virgjër, me vijë bregdetare të larmishme me gjire, kepa, ishuj e shkëmbinj interesante, me monumente kulture, me Butrintin dhe Sarandën afër, fare pranë ishullit të Korfuzit dhe rrugës detare nga Greqia në Itali, pra një pikë e rëndësishme që pret dorën e investitorëve, interesimin nga shteti si dhe vetë banorët e tij për ta mbrojtur e për të kërkuar dhe pritur pastaj zhvillimin e një turizmi elitar.




11.2. TË DHËNA GJEOGRAFIKE

Komuna Ksamil ndodhet në Krahinën Jugore të Shqipërisë dhe pikërisht në pjesën perëndimore të saj. Është komunë e rrethit të Sarandës dhe gjeografikisht ka një shtrirje tërheqëse. Komuna ka këto kufizime:

Veriu	Komuna Aliko
Jugu	Komuna Xarrë, Kanali i Vivarit.
Lindje	Komuna Xarrë dhe Aliko.
Perëndimi	Deti Jon.

Komuna Ksamil ka një sipërfaqe prej 63.6 km², popullsi prej 7716 banorë dhe përfshin në territorin e saj qytezën e Ksamilit dhe fshatin Manastir, por nga ana tjetër ndodhet qyteti antik i Butrintit, liqeni i Butrintit si dhe ishujt e saj.



11.2.1. QYTEZA E KSAMILIT

Kjo qytezë ndodhet në gjirin e Tetraniseve i cili futet në tokë rreth 1,3 km në thellësi të saj dhe ka gjerësi rreth 2.6 km. Ka një popullsi prej 7000 banorë. Ndodhet në lartësinë 268 m mbi nivelin e detit . Është një qytezë e ndërtuar në vitet 1973 me drejtim kryesor tashmë turizmin si dhe agrikulturën.



11.2.2. FSHATI MANASTIR

Është i vetmi fshat që përfshihet në këtë komunë. Ka filluar të popullohet në vitet e fundit dhe ka një popullsi prej rreth 450 banorë. Ndodhet në lartësinë 30 m mbi nivelin e detit Jon.

11.2.3. GADISHULLI I KSAMILIT

Shtrihet 12 km në Jug-Perëndim të Sarandës,ndërmjet kanalit të Butrintit në drejtimin Jug-lindje e Jug,detit Jon në perëndim,liqenit të Butrintit në Lindje dhe një rrypi të ngushtë në veri që e ndan nga Muri i Demës.Është i gjatë 8 km në drejtimin veri-jug dhe i gjerë me 5 km në jug deri ne 350 m në veri.Ka një sipërfaqe të përgjithshme 15 km².Ka relief kodrinor që zbret nga lindja në perëndim.Lartësia fillojnë me 234 m në jug-lindje në 187 m në veri e deri në 144 m ne jug-perëndim

Gadishulli i Ksamilit ka pesë gjire të vegjël të vendosur kryesisht në anën perëndimore dhe lindore të tij.Më i madhi është ai i Tetraniseve. Është një gji me një shtrirje prej 1.3 x 2.6 km² ndersa thellësitë shkojnë deri në 20 - 30m. Bukurinë e tij e shtojnë edhe katër ishujt e vegjël të veshur me shkurre me gjelbërim të përhershëm.Ky gji përfshin bregdetin nga qafa e Përmetit deri tek kepi i Mërtesës dhe në perëndim të kësaj të fundit ndodhen dy shkëmbinj që sot kanë marrë emrin si Shkëmbi i Pëllumbave.

Ka një bregdet shkëmbor e të thepisur. Është nga më të bukurat në detin Jon dhe krijon një mjedis piktoresk me natyrën shkëmbore në trajtë konikebKa bimësi me kombinime ngjyrash dhe gjelbërim të përhershëm.

11.2.4. GJIRI I PALLAVRAQIT

Ndodhet në lindje të gadishullit të Ksamilit,rrëzë kodrës së Sotirës,ku liqeni i Butrintit futet në tokë.Është gji shkëmbor me gjatësi 21 m dhe gjerësi 11m. Thellësitë në gji janë të vogla dhe të mbrojtura nga erërat. Bimësia gjatë vijës bregdetare është e varfër.

11.2.5. LIQENI I BUTRINTIT

Ndodhet në bregdetin e Jonit me një sipërfaqe prej 16.3 km², thellësi më të madhe 21.4 m dhe me një vëllim rreth 210 milionë m³.Është i rrethuar me kodra, përjashto anën veriore të tij. Ana perëndimore e tij është e rrethuar me shkurre dhe shkëmbinj të shumtë ndërsa ajo lindore me gjatësi 600 m ka disa plazhe ranore.Ujërat e tij ndahen në pjesën e sipërme ku shtresa

ka oksigjen dhe shtresa e poshtëme pa oksigjen.Në të rriten dhe kultivohen trofta,koca,midhja,karkaleci etj.

11.2.6. LAGUNA E BUTRINTIT

Shtrihet në bregun e gjirit të Butrintit,është tipike në Shqipëri dhe me origjinë të veçantë.Mendohet të ketë qenë gji Liqeni i Butrintit dhe me kalimin e kohës si rezultat i prurjeve te lumit Pavlla janë krijuar rripat ranorë që bejnë veçimin nga deti.Nëpërmjet kanalit të Vivarit kryhet një ujëshkëmbim me detin Jon, të cilat rritin vlerat ekologjike të kësaj lagune.

11.3. TË DHËNA SIZMIOLOGJIKE

Sipas” Studimit të Rajonizimit të Shqipërisë sipas Tërmeteve” të kryera nga Akademia e Shkencave si dhe duke ditur që Shqipëria bënë pjesë në rrypin bregdetar të Mesdheut Lindor që fillon nga Shqipëria Veriore deri në Greqinë Jugore dhe njihet si zonë me sizmicitet të lartë qe kap vlerat deri në 8 ballë, edhe Ksamili, si pjesë e këtij rajoni i nëneshtrohet teknikave dhe kushteve ndërtimore të tilla për të përballuar këto forca natyrore.Gëlqerorët që janë baza e ndërtimit të zonës nga pikëpamja gjeologjike bëjnë të mundur amortizimin e valëve sismike.

11.4. TË DHËNA KLIMATERIKE DHE HIDROLOGJIKE

Vera është stina më gjatë e vitit në Ksamil e cila fillon nga fundi i muajit Prill deri në muajin Shtator ku temperatura mesatare është 26°C. Si i gjithë rajoni bregdetar edhe këtu kemi klimë kontinentale mesdhetare me dimër të butë dhe të lagësht e verë të nxehtë dhe të thatë.

11.4.1. TEMPERATURA

Në muajt më të ftohtë temperatura mesatare shënon 8-10°C,ndërsa ne muajt më të nxehtë 25-26°C.Temperaturat më të ulëta lëkunden nga 0 ne - 2°C.Numuri i ditëve verore me temperaturë deri 26° C shkon rreth 120, i ditëve te nxehta me 30° C arrin në 40 ditë dhe i ditëve tepër të nxehta në 15.Numri i ditëve me diell në vit është rreth 300 ditë.

11.4.2. RRESHJET

Sasia mesatare e rreshjeve vjetore është 1600 mm,pjesa dërmuese e të cilave në stinën e vjeshtës dhe në atë të dimrit.Precipitimet kryesore janë ato në formë shiu, ndërsa të llojeve breshër janë të pranishme në ditë të veçanta sidomos në muajt Tetor dhe Mars. Rreshjet në formë dëbore takohen rrallë dhe kur ndodh është surprizë e natyrës duke ditur klimën e këtij rajoni.Rreshjet në momente të caktuara mund të jenë të vrullshme dhe të menjëherëshme.Numri i ditëve me shi është rreth 30 ditë

11.4.3. ERËRAT

Erërat e zakonshme janë puhitë detare nën ndikimin e të cilave ndodhet rajoni bregdetar.Kështu që Komuna Ksamil falë pozicionit gjeografik te saj i nënshtrohet të njëjtave kushte natyrore si i gjithë bregdeti. Shpejtësia mesatare e erës arrin deri në 2.3 m/sekond.Drejtimi i erërave ndryshon sipas stinëve po kështu edhe shpejtësia e saj.

11.5. TË DHËNA HIDROGJEOLOGJIKE DHE GJEOLOGJIKE

Nëse i referohemi Ishujve të Ksamilit ato janë formuar në periudhën e jerasikut e kratekut.Kanë origjinë gërryese të shkëputur nga toka dhe të ndërtuar nga gëlqerorë,kanë formë të rregullt konike dhe brigje abrazive relativisht të larta,ndërsa gjiri i Pallavraqit përbehet nga formacionet terrigjene gëlqerore dhe është formuar nga veprimi i detit.

Gadishulli i Ksamilit përbëhet nga gëlqerorë te jurasikut.Ka procese dhe fenomene karstike të mëdha me përhapje të gjerë shkrepat, zgavrimet shumëformëshe, hinkat,vrimat thithese dhe vende-vende pjesë të sheshta. Bregdeti i tij përshkohet nga një vijë e thyer shkëmbore me faleza pak të zhvilluara,koha e shkurtër e bashkëjetesës me detin nuk ka lejuar zhvillimin e plotë vertikal të tyre. Deti ka hyrë në tokë gjatë kuartenarit të vjetër.

Laguna e Butrintit është lagune tipike tektonike e periudhës së pliokuaternarit në formimin e të cilës kanë ndikuar edhe prurjet e ngurta të lumit Pavlla

11.6. TË DHËNA MBI SHFRYTEZIMIN E TOKËS , TË DHËNA PEDOLOGJIKE

Nga studimet pedologjike të kryera tokat e kësaj komune bëjnë pjesë ne tokat e hinjta kafe livadhore ku bimësia zotëruese janë makjet mesdhetare si dhe të hinjta kafe malore të cilat mbulojnë kodrat e ulta nga 200 m e lartë dhe janë të pjerrëta.

11.7. TË DHËNA MBI BOTËN BIMORE DHE SHTAZORE

11.7.1. FLORA

Si pjesë e Rajonit Bregdetar bimësia përbehet nga makjet mesdhetare si dhe bimësi e kultivuar.Në këtë zonë bënë pjesë Pylli i Butrintit i cili përbehet nga grumbuj pyjor me një sipërfaqe prej 25 ha.Është pyll me gjelbërim të përherëshëm me drurë gjethembajtës natyrore si: dafina përralli, ilqe, ullstra, fishekarthi dhe mimoza, kjo e kultivuar. Por ka edhe drurë gjetherënës si bliri, shelgu, vidhi, lofata, frashëri etj. Bimët kacavjerëse në gjelberim gjithëvjetor rriten në bashkëjetesë me drurët pyjorë.Nën këta drurë zhvillohet nje nënkat tjetër i gjelbër i përberë nga asparagus dhe lule shumëngjyrëshe.Ky pyll i ngjan një xhungle të vërtetë i cili ka vlera shkencore e turistike dhe është shpallur “Pasuri natyrore e rrallë”.

Por nga ana tjetër janë rreth 60.000 mijë rrënjë ullinj dhe 200.000 mijë rrënjë agrume të mbjella nga taracimi i kryer në vitet më parë ku sot një pjesë e tyre janë dëmtuar nga ndërtimet pa leje dhe dëmtime të dorës njerëzore.

11.7.2. FAUNA

Ndërsa lidhur me botën shtazore në pyllin e Butrintit gjenden kafshë dhe shpendë të vogla të cilat zhvillohen dhe shtohen falë shpalljes së zonës pyjore si pasuri natyrore,por nga ana tjetër kemi liqenin e Butrintit ku rriten dhe kultivohen lloje të ndryshme peshku dhe natyrisht deti që është një pasuri e paçmueshme për këtë komunë si nga pamja vizive ashtu edhe nga ato që ofron deti në brendësi përfshi botën bimore dhe shtazore të tij.

11.8. TË DHËNA ARKEOLOGJIKE,HISTORIKE,MUZEALE

Komuna Ksamil ofron jo vetëm peisazh të çmuar natyror,por edhe vlera të mëdha arkeologjike dhe historike,e kjo lidhet me qytetin antik të Butrintit i cili përmendet në shekullin e VI para Krishtit prej Hetakut, por mendohet që kodra e Butrintit të jetë banuar më parë lindjes së qytetit. Kemi shëtitoren,tempullin,kullën në hyrje të Butrintit që shërbente për kontrollin e kanalit të Vivarit dhe murin e Demës i cili ndante krejt gadishullin e Ksamilit në një tokë të zotëruar nga Butrinti.

Ky mur ka qenë portë hyrëse për në Gadishullin e Ksamilit,si dhe kisha e Shën-Gjergjit, Dema.

12. ANALIZA E NDIKIMIT NË MJEDIS

Ky kapitull analizon ndikimet ambjentale pozitive dhe negative te projektit te ***“Furnizimin me ujë të pijshëm të lagjes nr. 3 (Marina), Ksamil dhe fshatit Manastir, Komuna Ksamil”***

Çdo projekt ndikon në mjedis në tre faza kryesore të cilat janë

- Para ndërtimit
- Gjatë ndërtimit
- Gjatë funksionimit

Krahasimi i situatave "me projekt " dhe "pa projekt", është bërë në formën e nje matricë për çështjet / ndikimi në mjedis (tabela e mëposhtëme). Kjo analize prezanton menjëherë çështjet kryesore mjedisore dhe ndikimet e mundshme mjedisore që mund të jenë pozitive apo negative.

Ndikimet janë të klasifikuara:

- Ndikim shume negativ mjedisor (=),
- Ndikim mjedisor negativ per momentin (-),
- Ndikim mjedisor i papërfillshëm (O)
- Ndikimi pozitiv mjedisor (+).

13. MATRICA E ÇESHTJEVE/NDIKIMEVE MJEDISORE

Faza	Paramentrat mjedisore	"pa projekt"	"me projekt"
Faza prapake (para ndërtimit)	<ul style="list-style-type: none"> • Kredibiliteti i furnizimit me ujë • Kredibiliteti i cilësisë së ujit • Ndotja e mundshme • Tokë e zënë dhe zhvendosje e njerëzve • Shfrytëzimi i tokës dhe ndalimi i aktivitetit ekonomik 	= O = O O	+ O + O O
Faza e ndertimit	<ul style="list-style-type: none"> • Ndalimi i përdorimit të tokës • Humbje të bimësisë natyrore • Dëme në rrjedhën e ujërave ose dëme në habitatin ujqor • Ndotja e Ujit dhe e Tokës • Probleme me zhurmat, ndotja e ajrit, trafiku etj • Erozioni • Punësimi 	O O O O O O O	O — O — — — +
Funksionim & Mirembajtje	<ul style="list-style-type: none"> • Shëndeti publik • Ndotja e ujit • Erozioni • Rritje të sasisë së tokës • Zgjerim i aktivitetit ekonomik 	= — O O O	+ — O + +

Në përgjithësi, projekti duhet të ketë një ndikim pozitiv për popullsinë e Ksamilit.

Cilësia e ujit dhe mundësia e pakët e ndotjes së tij do të përmirësohen në mënyrë të ndjeshme dhe kjo do të rezultojë gjithashtu në një shëndet të mirë publik. Gjithashtu do të përmirësohet për një periudhë afatshkurtër punësimi përgjatë fazës së ndërtimit por avantazhet ekonomike do të jenë afat-gjata. I vetmi ndikim negativ afat-gjatë për projektin është ndotja e vazhdueshme e shkaktuar nga mungesa e sistemit të kanalizimit të ujërave të përdorura.

13.1. NDIKIMET E LIDHURA ME FAZËN E NDËRTIMIT/EKZEKUTIMIT TË PUNIMEVE CIVILE

- 1 Në fazën fillestare të punimeve, do të kryhet punë përgatitore për pastrimin e vendit dhe përgatitje për fillimin e punimeve. Aktivitete të tilla që kërkojnë prerjen e vegjetacionit dhe /ose pemëve duhet të monitorohen çdo ditë.
- 2 Vendet e propozuara te ndërtimit janë brenda ose ngjitur me zonat e banimit. Pluhuri që gjenerohet nga ndertimi dhe materialet e ndërtimit të depozituara në vend gjatë ndërtimit mund të jenë ndikimet afat-shkurtra negative mbi mjedisin rrethues. Masat zbutëse përfshijnë mbulimin e vendeve/materialeve që gjenerojnë pluhur, ndërtimi i mureve mbajtes për të kontrolluar rreshqitjet e tokes, si dhe punimet mbrojtese të tokës në të njëjten kohë me qëllim minimizimin e ndikimeve negative në terren.
- 3 Punimet e ndërtimit depos së ujit në Manastir, shtrimet e tubacioneve te ujit do të kërkojnë përdorimin e makinerive dhe automjeteve të ndërtimit. Punimet e ndërtimit mund të prodhojnë zhurma afatshkurtra, dridhje të tokës, ndotjen e ajrit, rrëshqitje, rreziqet në lidhje me sigurinë e punëtorisë dhe publikut, si dhe bllokime nga trafiku. Praktikrat e mira të tilla si: reduktim të sasisë së pluhurit, montimin e kontrolluar të materialeve, si dhe larja e gomave të kamionëve para se të nisen në sheshin e ndërtimit, etj janë disa nga masat për mbrojtjen e mjedisit që do të adoptohen në specifikimet e kontratës.
- 4 Zhurmat dhe dridhjet e tokës mund të krijohen gjatë ndërtimit me makineri të rënda të ndërtimit, duke përfshirë ekskavatorë, buldozerë, miksera betoni, dhe mjeteve të transportit. Në përgjithësi, zhurmat nga makinerite e ndërtimit tejkalojnë nivelet e zhurmës prej 70 decibel (dB) dhe kane ndikime të rëndësishme në

receptorët e ndjeshëm rrethues brenda 50 m të sheshit të ndërtimit. Masat kryesore për zvogëlimin e zhurmave do të përfshijnë:

- asnjë punim ndërtimi gjatë natës me makineri të rënda, nga ora 22:00 në orën 6:00 afër zonave të banuara,
- mos përdorim diskret të makinerive të zhurmëshme brenda 50 m të zones së banimit,
- mirëmbajtjen dhe funksionimin e duhur të makinerive të ndërtimit për të minimizuar burimin e zhurmës,
- vendosja e barrierave të përkohshme për zhurmat nëse është e nevojshme,
- zgjedhjen e rrugëve të transportit për mjetet e rënda me qëllim shmangien e kalimit mes zonave të banuara.

5 Masat që duhet të adoptohen për të minimizuar pluhurin gjatë ndërtimit përfshijnë:

- mbylljen ose rrethimin e vendeve të ndërtimit
- shpërndarjen e ujit në rrugët e pluhurosura
- ruajtjen e përmbajtjes së ujit në materialet e ndërtimit,
- përdorimi i mbulesave nga automjetet e transportit, kontrolli i shpejtësisë së automjeteve, si dhe zgjedhja e rrugëve të transportit për të minimizuar ndikimin nga pluhuri
- minimizimi i kohës së qëndrimit në vend-ruajtje apo magazinim të materialeve të ndërtimit.

6 Të gjitha automjetet dhe makineritë e ndërtimit duhet të veprojnë në përputhje me standardet relevante për automjetet dhe të kenë mirëmbajtjen e duhur për të minimizuar ndotjen e ajrit.

7 Trafiku, ndotja e ajrit dhe shqetësimet për këmbësorët dhe pronarët e aktivitetëve tregëtare janë problemet potenciale për t'u trajtuar përse i përket shtrimit të tubacioneve të ujit, sidomos kur përdoret metoda për germimin e çarjen e terrenit sikurse

- propozohet në projekt. Masat zbutëse përfshijnë rregullimin e trafikut në kalimet rrugore, ndërtimin e rrugëve të ndërmjetme, duke kërkuar mundësi për zgjedhjen e rrugëve të transportit që reduktojnë trafikun, shmangien e trafikut në orët e pikut të tij, si dhe rikthimin e rrugëve në gjendjen e mëparshme sa më shpejt të jetë e mundur.
- 8 Punimet e ndërtimit do të interferojnë me shërbimet ekzistuese nëntokësore [si p.sh tubacionet e ujit ekzistuese, linjat e komunikimit (internet, telefoni, nese, ka) dhe kabllot elektrike] si dhe mund të ketë pezullime të përkohshme të shërbimit. Shmangia e shërbimet të tjera duhet të konsiderohet me kujdes hartimin e projektit të detajuar teknik dhe gjatë procesit të ndërtimit të veprës. Masat urgjente duhet të ndermerren me qëllim minimizimin e ndikimeve negative.
- 9 Ndërtimi i Depos së re të ujit mund të kërkojë zhvendosjen e rrugëve ekzistuese si dhe të linjave të komunikimit dhe ato elektrike apo qoftë edhe shtrimin e tyre drejt objektit. Projekti do të përgatitet në mënyrë të tillë që ndërtimi të jetë i planifikuar me kujdes dhe të minimizojë ndikimet mbi aktivitetet e ndryshme dhe zonat kullosore brenda zonës. Është e nevojshme të minimizohet prerja e pemëve të rëndësishme .
- 10 E njëjta gjë mund të jetë për ndërtimin e linjave të tubacionit të ujit në lidhje me vegjetacionin prezent përgjatë sheshit të ndërtimit. Këto ndikime janë të përkohshme. Shtresa e punueshme do të ruhet dhe vegjetacionit origjinal do të mbulohet e rimbillet menjehere pas ndërtimit. Nuk kane ndikime të rëndësishme negative në mjedisin lokal ekologjik.

13.2. NDIKIMET MJEDISORE NË FAZËN E FUNKSIONIMIT DHE MIRËMBAJTJES

13.2.1. *Ndikimet nga funksionimi i rezervuarëve dhe veprës së marrjes së ujit (Depua e re)*

- 1 Rreziku nga rrëshqitje të rezervuarëve do të jetë relativisht i ulët për shkak të stabilitetit gjeologjik në vendin e ndërtimit, probabilitetit të ulët të tërmeteve në zonat e rezervuarëve si dhe përdorimin e shkallës Rihter 8 si kriter sizmiologjik në projektim për rezervuarët e rinj .
- 2 Një tjetër masë e marrë, është ajo në lidhje me eliminimin e riskut duke projektuar rezerva uji të ndara në vende të ndryshme dhe duke shmugur koncentrimin e volumeve të mëdha të ujit në të njëjtin vend.
- 3 Veprimtaria normale e bimësisë në zonën e projektit nuk e përkeqëson cilësinë e ujit. Gjithashtu nuk ka ndotje të burimeve ose përdorime të rëndësishme të kimikateve bujqësore në rrjedhën e sipërme të rezervuarit dhe ka shume pak erozion të tokës

13.2.2. *Ndikimi nga tubacionet e linjës së dërgimit dhe rrjeti i shpërndarjes*

- 1 Me realizimin e një projekti teknik optimal si dhe ndërtimin e një sistemi të ri ujësjellësi, përqindja e mundësive për rrjedhje nga tubacionet do të ulet shume, gjë e cila do të rezultojë në një cilësi të përmirësuar të ujit të pijshëm.
- 2 Ndikimet kryesore nga funksionimi dhe mirëmbajtja e tubacioneve të ujit lidhen me aktivitetet e riparimit apo zëvendësimit kur ka rrjedhje ose shpëputje të tubacioneve. Një program duhet të krijohet me qëllim evidentimin e rrjedhjeve, defekteve etj dhe

zëvendësimin e tubacioneve të vjetra me qëllim mosndërprerjen e punës së sistemit të furnizimit me ujë. Me qëllim reduktimin e ndikimeve si zhurmat, pluhuri, trafiku etj, operatori i sistemit të furnizimit me ujë (Komuna Ksamil) duhet të ndjekë zbatimin e një plani të menaxhimit mjedisor dhe masat zbutëse përkatëse të ngjashme me ato gjatë fazës së zbatimit.

13.2.3. Ndikimet nga procesi i dezinfektimit të Ujit- Sistemi i Ujësjellësit

- 1 Për kontrollin e automatizuar e trajtimit të klorit duhet të instalohen pajisje të vecanta. Furnitorët e këtyre pajisjeve duhet të ofrojnë edhe manualin operacional si dhe duhet që të ofrojnë trajnimet e nevojshme për sigurinë e përdorimit të këtyre pajisjeve dhe procedurat emergjente do të ofrohen para vënies në punë te ujësjellësit te ri. Në vazhdimësi duhet që të kryhet trajnimi periodik dhe sesione praktike mbi procedurat operacionale për punonjësit e Ndërmarrjes së Ujësjellësit.
- 2 Rrjedhje të substancave të dezinfektimit të ujit (p.sh klorit) mund të rezultojë në lëndime serioze ndaj punëtorëve dhe dëmtime të pronës. Me qëllim që të eliminohet në maksimum ky fenomen duhet të instalohen pajisje për klorimin me anë të një sistemi automatik

14. PËRMBLEDHJE E NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME MJEDISORE

Punimet për rehabilitimin dhe ndertimin e sistemit të furnizimit me ujë mund të kenë ndikim negativ në mjedis në varësi në zbatimin e Punimeve Civile nga ana e Kontraktorit.

Megjithëse shumica e këtyre ndikimeve janë të përkohshme, ato duhet te minimizohen sa më shumë të jetë e mundur.

Ndikimet negative mjedisore më te rëndësishme janë:

- Dëmtime të mjedisit natyror dhe tokës: (përkohësisht)
- Ndotje te Uji dhe tokës: (përkohësisht)
- Shqetësime të popullatës lokale nga: zhurma, ndotja e ajrit, trafiku: (përkohësisht)

- Shëndeti dhe Siguria
- Vendet historike dhe kulturore: Punimet e ndërtimit si gjurmimet për shtrimin e tubacioneve në rrugët e Komunës. (përkohësisht)

15. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

15.1 Konkluzione:

Projekti ***“Furnizimin me ujë të pijshëm të lagjes nr. 3 (Marina), Ksamil dhe fshatit Manastir, Komuna Ksamil”*** do të rrisë sasinë e furnizimit me ujë të pijshëm duke i dhënë zgjidhje mungesës për ujë të pijshëm në disa zona periferike siç është lagja nr.3 e Ksamilit dhe fshati Manastir, do të përmirësohet cilësia e ujit të pijshëm, duke ndikuar edhe në përmirësimin e shëndetit publik.

Kjo gjithashtu do të ndikojë në zhvillimin e ekonomisë lokale i cili është bazuar kryesisht në sektorin e turizmit duke përmbushur treguesit standart që kërkohen për sigurimin e ujit të pijshëm në sasinë e cilësine e duhur për turistët / vizitorët.

Është pranuar gjithsesi që ndërtim/rehabilitimi dhe përmirësimi i dallueshëm i kushteve të furnizimit me ujë do të rrisë sasinë e ujit të ndotur që do të prodhohet. Kjo u konsiderua në mënyre të moderuar si impakt negative afatgjatë. Gjithashtu, humbja e burimeve ekologjike është konsideruar e parëndësishme. Nuk ka habitate të rëndësishme ose specie që do të dëmtohen apo të kërcënohen nga ndërtimi i veprës. Ndikimet e tjera negative në mjedis do të jenë minimale dhe do të merren masa zbutëse.

15.2. Rekomandime:


Për përmirësimin e gjendjes së burimeve ujore, dhe rezervuarve të ujit që shërbejnë për furnizimin me ujë të Ksamilit, rekomandojmë:

- Përreth burimeve, depove dhe stacioneve të pompimit të krijohen zonat e mbrojtjes sanitare

- Zona të rrethohet me tel gabion, në mënyrë që të mos hyjnë në të njerëz të paautorizuar dhe kafshë.
- Brenda kësaj zone nuk duhet lejuar asnjë aktivitet industrial, ndërtim banesash, ose aktivitet bujqësor me përdorim pesticidesh apo plehërash pasurimi për bujqësinë.
- Në këtë zonë nuk lejohet hedhja e mbetjeve, gropat septike, depozitim i materialeve të ndryshme, përfshi ato kimike, etj.
- Të merren masa për klorifikimin e ujit, para dërgimit të tij ne depon kryesore.


PUNOI MATERIALIN

SPECIALISTE E MJEDISIT SULBENA BALILAJ



ING. SULBENA BALILAJ
V.N.M. E AUDITIM
MJEDISOR- EKSPERTE

FLETA ORJENTUESE E SKEMES SE RRJETIT SHPERNDARRES
 Shk. 1:5000



LEGJENDA

- Linjat kryesore Egzistuese
- Linja kryesore te reja
- Linjat sekondare
- Lidhjet e konsumatoreve
- Emertimi i nryeve Faza 1
- Emertimi i nryeve Faza 2
- Hidrant
- Specifikimi i degëve kryesore
- Specifikimi i sekondareve
- D eshte nryja nga del

34
B




INVESTITORI:
KOMUNA KSAMI

PROJEKTI NO:	PROJEKTI NO:
SHALLA 1:5000	SHALLA 1:5000
DATA SHIKIM 2019	DATA SHIKIM 2019
Projektet	Projektet
V. Hicka	V. Hicka
Faza:	Formulim
Projekt Zbatim	Projekt Zbatim
FLETA:	FLETA:
UK-05	UK-05

RESPONJOR:	GRUPA
HUK	HUK
Consulting	Consulting
Engineers	Engineers
Adresa	Adresa
Buzarete 2001	Buzarete 2001
0-20	0-20
2001 2001	2001 2001
04 4 2023 402	04 4 2023 402
Hydroreputim dhe rregullim kanalizim	Hydroreputim dhe rregullim kanalizim

LETA ORJENTUESE E PIKETIMIT TE SKEMES SE RRJETIT SHPERNDARRES

Shk. 1:5000



INVESTITORI:

KOMUNA KSAMILI

ESKIMUAR	DATA	MA	PROJEKTI NO.
HUK			Skema 1:5000
Consulting			
Engineers			
Adresa: P.O. Box nr. 2006, I Tirane, Shqipëria Teli: +355 022 880 Fax: +355 022 862 Nënpjesëtarë: Nënpjesëtarë/ta		D/W Visitor 2018 Projektor V. Hicka	
Fleta		Ekipimi	
Projekt Zbatim		FLETA:	
		U.K.14	

TITULLI I PROJEKTI:

UJESJELLESI I KSMILIT-VAZHDIM
dhe Fshati Manastir

Titull i Vazhdim

FLETA ORJENTUESE E PIKETIMIT TE
SKEMES SE RRJETIT SHPERNDARRES

Fleta


Projekt Zbatim

Ekipimi

FLETA:

U.K.14

FLETA ORJENTUESE E SKEMES SE RRJETIT TE BRENDSHEM FSHATI MANASTIR SHK.1 :2000



PLANIMETRIA E RRJETIT TE BRENDSHEM
FSHATI MANASTIR SHK.1 :1000
NYJE 3 - NYJE 4


PLANIMETRIA E RRJETIT TE BRENDSHEM
FSHATI MANASTIR SHK.1 :1000
NYJE 1 - NYJE 3

INVESTITORI KOMUNA KSAMIL	
Emri i Projektit	UJESJELLESI I KSAMILIT-Vazhdim
HUK Consulting Engineers	Shefi i Vezesit
Adresa: Shkollë e Fshatit Manastir	Drejtuesi i Projektit
Posta: 17000	Projektori
Telefoni: 037 200 209	Vizuesi
Faxi: 037 200 682	Praktikanti
Emri i Autorit	U.M.2

INVESTITORI KOMUNA KSAMIL	
Emri i Projektit	UJESJELLESI I KSAMILIT-Vazhdim
HUK Consulting Engineers	Shefi i Vezesit
Adresa: Shkollë e Fshatit Manastir	Drejtuesi i Projektit
Posta: 17000	Projektori
Telefoni: 037 200 209	Vizuesi
Faxi: 037 200 682	Praktikanti
Emri i Autorit	U.M.2

INVESTITORI KOMUNA KSAMIL	
Emri i Projektit	UJESJELLESI I KSAMILIT-Vazhdim dhe Fshati Manastir
HUK Consulting Engineers	Shefi i Vezesit
Adresa: Shkollë e Fshatit Manastir	Drejtuesi i Projektit
Posta: 17000	Projektori
Telefoni: 037 200 209	Vizuesi
Faxi: 037 200 682	Praktikanti
Emri i Autorit	U.M.20





**KOOREOGRAFIA E LINJES SE JASHTME TE UJESJELLESIT
TE KOMUNES KSAMIL dhe fshati MANASTIR**



INVESTITORE:		KOMUNA KSAMIL	
Titulli i Projektit	Projekti Nr.	Shikatto	
Titulli i Vezhimit	Data e Autorit	Projektor	
Faza:	Kontrollo	Kontrollor	
Projekti Zbatim		FILETA: U.M-03	

HUK
Consulting
Engineers

Adresa:
Bulevardi ZOGJ I
P-38
Tet. 4 2420 200
Faks 4 2232 662
NAJORA JETI/SHKOLLOR
HAKRO JETI/SHKOLLOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 224 572 Fax. 0 4 270 627 www.moe.gov.al

Nr. 675 Prot.

Tiranë, më 30.10.2006

Vendimi nr. 9, Nr. 223 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

"Sulbenaj BALILAJ"

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Lufter XHUVELI





LICENCË

LN-7464-02-2014	NUIS/NIPT: L46404209F
Subjekti: Sulbena Balilaj	
Adresa: Vlore, VLORE, Vlore, VLORE, Lagjja Pavarësia, Pallati Riviera 1, Kati 3	
Kodi: III.2.A	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 12/02/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis(1. Ndikim në mjedis
2.Auditim mjedisor)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë



Nënshkrimi i sportelit:

Blerina Ilnica



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

OKR
Qendra Kombëtare e Regjistrimit
National Registration Center

NUMRI SERIAL:
SN-219236-02-14

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të tatueshëm:

Sulbena Ballilaj – Person Fizik

Statusi:

Aktiv

Me adresë kryesore:

Vlore, Vlore, Lagjja Pavaresia, Pallati Riviera 1, Kati 3

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):

L46404209F

Afati i veprimtarisë:

Nga: deri

DATA E REGJISTRIMIT

04/02/2014

DATA E LËSHIMIT

05-02-2014

SPORTELI I SHËRBIMIT:

Vlore



QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

Berina Ilirica

Emri, Mbiemri i nëpunësit të sportelit të tatueshëm.

Kjo certifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji të të dhënave të regjistruara.

Kjo certifikatë shprehësiht e ndaluar të plasifikohet